




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.3, datë 30.05.2025



PËR

**MIRATIMIN E “KËRKESË PËR AUTORIZIM PËR PËRDORIMIN
E BURIMIT UJORË PËR NDËRTIM, RINDËRTIM APO SHËMBJE
PËR MBROJTJEN E BRIGJEVE MUREVE DHE PRITAVE E
VEPRAVE TË TJERA NË BRIGJE”
SUBJEKTI BASHKIA ELBASAN**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 141, të ligjit Nr.29/2024 “Për burimet ujore”, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Kërkesë për autorizim për përdorimin e burimit ujorë për ndërtim, rindërtim apo shëmbje për mbrojtjen e brigjeve mureve dhe pritave e veprave të tjera në brigje” për subjektin Bashkia Elbasan për të zhvilluar projektin: “Ndërtimi i tombinos box në funksion të Auto-Motoparkut Elbasan”.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:
 - Koordinatat e pritës lumore

Pika	Koordinata X	Koordinata Y	Koordinata Z
Fillimi	508124.034	4551838.044	108
Mbarimi	508215.791	4551914.13	108

Lloj i veprimtarisë që do të kryet :



- Ndërtimi i tombinos box në funksion të Auto-Motoparkut Elbasan
- 3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

ILIR BEJTJA

